



UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
— FERIZAJ —

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Prof. As. Dr. Samet Dalipi

Nr. Prot.: 1472/21; Datë: 27.05.2021

Në bazë të nenit 143, paragrafit 2 të Statutit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me datë 27.05.2021, merr

V E N D I M

- I. Miratohet Rregullorja për Zgjedhjet Studentore në UShAF.
- II. Vendimi hynë në fuqi nga dita e nënshkrimit të tij.

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues i UShAF për qëllim të harmonizimit të akteve të brendshme me Statutin e UShAF, pas elaborimit të draft rregullores në fjalë, në mënyrë unanime vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. Këshillit Drejtues të UShAF;
2. Arkivit të UShAF;

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Prof. As. Dr. Samet DALIPI



UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
FERIZAJ

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Prof. As. Dr. Samet Dalipi

Nr. Prot: 1472/21, Dt.: 27.05.2021

RREGULLORE PËR ZGJEDHJET STUDENTORE
NË UNIVERSITETIN E SHKENCAVE TË APLIKUARA
NË FERIZAJ

Ferizaj, Maj 2021

S. D.

Në mbështetje të nenit 143, paragrafi 2, të Statutit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), Këshilli Drejtues i UShAF në mbledhjen e mbajtur me datën 27.05.2021, miraton:

RREGULLORE PËR ZGJEDHJET STUDENTORE TË UNIVERSITETIT TË SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Kjo Rregullore përcakton procedurën dhe organizimin e zgjedhjeve për anëtarët e Parlamentit të Studentëve në nivel të UShAF-it nga njësitë akademike të UShAF-it.

Neni 2

1. Studentët kanë të drejtë të themelojnë organizata studentore, të cilave mund t'iu përkasin të gjithë studentët e nivelit bachelor dhe master të regjistruara në UShAF;
2. Secila organizatë studentore duhet të ketë statutin e vet që aprovohet nga anëtarët e saj dhe në pajtim me këtë Rregullore;
3. Statuti do të përfshijë parimet për mundësi të barabarta dhe mosdiskriminim.

Neni 3

1. Interesat e studentëve do të përfaqësohen në Universitet përmes Parlamentit të Studentëve.
2. Organizatat studentore kanë të drejtë të propozojnë anëtarët për Parlamentin e Studentëve nga njësitë akademike, në bazë të rezultateve të zgjedhjeve në çdo dy vjet.
3. Studentët, të cilët kanë të përsëritur vite të studimeve, nuk mund të kandidohen, përkatësisht të zgjedhen në pozita udhëheqëse studentore.
4. Studentët, të cilët janë pjesë e organeve drejtuese të partive politike, nuk mund të kandidohen në listat zgjedhore të organizatave studentore.
5. Studentët në pozita udhëheqëse (kryetari dhe nënkryetari), duhet të kenë së paku notën mesatare 8.00.
6. Me rastin e diplomimit, pushimit të statusit të studentit, apo të rasteve të tjera kur mandatarin mungon, ose nuk mund të ushtrojë mandatin e fituar gjatë kohës sa ishte

S.O.

student, funksioni ndërpritet së ushtruari. Mandati i mbetur vakant plotësohet me kandidatin e radhës të renditur në listën e çertifikuar të kandidatëve të nominuar.

Në rast të shterrjes së listave të kandidatëve të nominuar të cilët janë certifikuar, në interes të funksionimit të Parlamentit të Studentëve, Këshilli Drejtues i UShAF merr vendim për plotësimin e listave nga Organizata Studentore e njëjtë fituese në zgjedhje.

II. Parlamenti i Studentëve

Neni 4

1. Parlamenti i Studentëve është organ suprem i përfaqësimit të studentëve. Ai përmes të anëtarëve të deleguar, merr pjesë në organet qeverisëse të UShAF, në rastet kur vendoset për çështjet studentore dhe akademike në nivel të UShAF.
2. Parlamenti i Studentëve zgjedhë një (1) anëtar student përfaqësues në Senat, i cili duhet të ketë notën mesatare gjatë studimeve së paku 8.00.
3. Parlamenti i Studentëve zgjedhë një (1) anëtar student prej radhës së studentëve për përfaqësues në Këshillin Mësimor/Shkencor, i cili duhet të jetë me notë mesatare së paku 8.00.
4. Parlamenti i Studentëve duhet të fokusohet në temat si në vijim:
 - Interesat e studentëve në nivel të Universitetit;
 - Angazhimi për cilësinë në mësimdhënie dhe mësimxënie;
 - Studimet që ndërlidhen me aspektet e reformave në UShAF dhe zhvillimet akademike;
 - Zhvillimin e cilësisë së të mësuarit dhe të vlerësimit;
 - Bursat universitare;
 - Ndihmat (bursat) sociale;
 - Çështjet tjera të përgjithshme të interesave akademike të studentëve;
 - Organizimin e aktiviteteve kulturore e sportive;
 - Zhvillimet e aktiviteteve studentore në kuadër të UShAF;
 - Interesat e studentëve në nivel të UShAF;
 - Studimet që ndërlidhen me aspektet e reformave të UShAF dhe zhvillimeve akademike;

S. D.

- Pjesëmarrja në të gjitha komisionet nëpër njësitë akademike dhe organeve të tjera qeverisëse të UShAF-it;
- Çështje tjera të ngjashme.

Neni 5

1. Numri i tërësishëm i anëtarëve të Parlamentit të Studentëve është 9 (nëntë).
2. Anëtarët e Parlamentit të Studentëve do të zgjedhen nga zgjedhjet studentore të UShAF, ku secila organizatë studentore e pranueshme, do të bëjë fushatë në bazë të listës së kandidatëve.
3. Ndarja e mandateve për secilën organizatë studentore që bënë fushatë, varet nga numri i përgjithshëm i përqindjes së votave që arrihet gjatë zgjedhjeve, sipas kësaj Rregulloreje.
4. Zgjedhjet e Parlamentit Studentor do të udhëhiqen nga Komisioni Qendror Zgjedhor.
5. Votat e organizatave studentore, të cilat nuk e kanë arritur pragun prej 5% të numrit të përgjithshëm të votave për Parlamentin e Studentëve, nuk do të shpërndahen në organizata të tjera të studentëve të kualifikuara për përfaqësim në Parlamentin e Studentëve.

Neni 6

Kandidati i përfaqësuar si përfaqësues i studentëve në Senat dhe Këshill Mësimor/Shkencor, delegohet nga përzgjedhja të cilën e bënë Parlamenti i Studentëve.

III. Parimet e zgjedhjeve

Neni 7

1. Regjistrimi i organizatave të reja studentore bëhet në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, konform Ligjit Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare.
2. Të gjitha organizatat studentore, të cilat janë regjistruar në mënyrë të rregullt si "shoqatë"-"asociacion" në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike sipas ligjit në fuqi, konsiderohen të regjistruara, ndërsa themelimi i organizatave të reja duhet të regjistrohen së paku 11 ditë para datës së zgjedhjeve.
3. Organizatat studentore kanë të drejtë të regjistrohen për:
 - Përfaqësim të përgjithshëm të studentëve të UShAF;

4. Bartësi i autorizuar i Organizatës Studentore të regjistruar në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike duhet të jetë student aktual në UShAF.
5. Numri minimal i deklaratave mbështetëse nënshkruese, i nevojshëm për organizatat studentore për të arritur pranueshmërinë, duhet të përcaktohet sipas rregullave të kësaj Rregulloreje.
6. Organizata studentore, për t'u certifikuar nga KQZ i UShAF duhet t'i sigurojë 100 nënshkrime mbështetëse (për ato që regjistrohen për herë të parë), ndërsa për organizatat e regjistruara më herët dhe që janë funksionale, nuk duhen nënshkrimet mbështetëse.
7. Në deklaratën mbështetëse duhet të shënohet: Emri dhe mbiemri i studentit, numri i ID - dosjes, fakulteti, programi i studimit dhe nënshkrimi.
8. Në rast se konstatohen parregullsi në plotësimin e shënimeve, Komisioni Qendror Zgjedhor mund të anulojë regjistrimin e organizatës studentore.
9. Data kualifikuese për organizatat studentore, për të fituar të drejtën e pjesëmarrjes në zgjedhjet studentore, do të caktohet 11 ditë para ditës së zgjedhjeve. Procesi i regjistrimit dhe licencimit duhet të përfundojë në atë datë.

Neni 8

1. Anëtarët e Parlamentit të Studentëve zgjedhen në pajtim me procedurat për zgjedhje parlamentare.
2. Gjatë zgjedhjeve do të aplikohet sistemi i përfaqësimit proporcional. Kjo siguron që, secila organizatë studentore që ka fituar numrin e përgjithshëm të votave mbi pragun përkatës të arritur, do të fitojë numrin e ulëseve në proporcion me përqindjen e votave të cilat ata i kanë marrë.
3. Limiti (pragu) për nominimin e anëtarëve të organizatave studentore është:
 - 5% i numrit të përgjithshëm të votave për Parlamentin e Studentëve.

Neni 9

Mandati i anëtarëve të Parlamentit të Studentëve zgjatë 2 vjet dhe fillon me 1 tetor të vitit kur mbahen zgjedhjet.

Neni 10

1. Zgjedhjet e studentëve shpallen nga Këshilli Drejtues i UShAF.
2. Zgjedhjet e studentëve mbahen jo më larg se 25 ditë pasi të shpallen zgjedhjet nga Këshilli Drejtues i UShAF. Data e saktë përcaktohet nga Këshilli Drejtues.

3. Organizatat e studentëve që fitojnë të drejtën për të marrë pjesë në zgjedhjet studentore në nivel të UShAF, duhet të mbajnë fushatën bazuar në listën prioritare të kandidatëve, gjithnjë duke respektuar nenin 7, pika 2 dhe nenin 8, pika 2 të kësaj Rregulloreje.
4. Periudha e fushatës zgjedhore për organizatat e studentëve do të fillojë në ditën e shpalljes së zgjedhjeve dhe do të përfundojë 24 orë para datës së zgjedhjeve, duke e llogaritur kohën që nga ora 00:00 e ditës së shpalljes së zgjedhjeve. Zgjedhjet do të udhëhiqen nga Komisioni Qendror Zgjedhor i UShAF, ndërsa do të monitorohen nga institucione, organizata dhe palë të tjera të interesit për monitorim të zgjedhjeve.
5. Shkeljet eventuale të rregullave zgjedhore do të sanksionohen nga Komisioni Qendror Zgjedhor dhe Këshilli Drejtues, si organ i shkallës së dytë.

IV. Komisioni Qendror Zgjedhor

Neni 11

1. Komisioni Qendror Zgjedhor formohet nga Këshilli Drejtues, me rastin e marrjes së vendimit për ditën e shpalljes së zgjedhjeve. Kryesuesi dhe zëvendëskryesuesi i Komisionit Qendror Zgjedhor caktohet nga Këshilli Drejtues i UShAF, të njëjtën ditë kur bëhet shpallja e zgjedhjeve.
2. Komisioni Qendror Zgjedhor përbëhet nga anëtarët si në vijim:
 - Sekretari i Përgjithshëm i UShAF;
 - Tre anëtarë nga personeli akademik;
 - Një anëtar nga personeli administrativ;
 - Një përfaqësues nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në cilësi të monitoruesit, pa të drejtë vote;
 - Një përfaqësues nga KQZ e Republikës së Kosovës në cilësi të monitoruesit, pa të drejtë vote.
3. Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet të dërgojë kërkesë me shkrim për të marrë emrat e nominuar nga organizatat nominuese sipas paragrafit (2) të këtij neni që në ditën e shpalljes së zgjedhjeve. Kjo shkresë duhet t'iu dërgohet së bashku me një ftesë për mbledhjen konstituive. Nominimet duhet të dorëzohen me shkrim te kryesuesi i Këshillit Drejtues, më së voni një ditë para mbajtjes së takimit konstituiv. Nominimet e vonuara nuk do të bëjnë pezullim të procedurave. Mbledhjen konstitutive e fillon kryetari i Këshillit Drejtues.

S. D.

4. Sekretari i Përgjithshëm është kryetar i KQZ "ex officio" (sipas detyrës zyrtare). Zëvendëskryetari zgjedhet nga radhët e personelit akademik.
5. Komisioni Qendror Zgjedhor është përgjegjës për përgatitjen, udhëheqjen dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve studentore.
6. Rezultatet e zgjedhjeve shpallen ekskluzivisht nga Komisioni Qendror Zgjedhor.
7. Komisioni Qendror Zgjedhor duhet të aprovojë dokumentin punues për punën e Komisionit Zgjedhor dhe udhëzimet për votim 7 ditë pas konstituimit.

V. Komisioni Zgjedhor

Neni 12

1. Komisioni Zgjedhor formohet nga Këshilli Drejtues, me rastin e marrjes së vendimit për ditën e shpalljes së zgjedhjeve. Kryesuesi dhe zëvendëskryesuesi i Komisionit Zgjedhor caktohet nga Këshilli Drejtues i UShAF, të njejtën ditë kur bëhet shpallja e zgjedhjeve.
2. Këshilli Drejtues mund të autorizoj Komisionin Zgjedhor që të kryej të gjitha veprimet e komisionerëve në vendvotim.
3. Komisioni Zgjedhor përbëhet nga anëtarët si në vijim:
 - Pesë (5) anëtarë nga stafi administrativ i UShAF.
 - Në rastet kur organizohen zgjedhjet studentore, komisionit 5 anëtarësh i shtohen edhe dy (2) vëzhgues pa të drejtë vote, prej të cilëve nga një (1) vëzhgues prej organizatave studentore me numër më të madh të votave në zgjedhjet e fundit.
 - Kryesuesi dhe zëvendëskryesuesi i Komisionit Zgjedhor zgjedhen nga Këshilli Drejtues dhe duhet të jenë nga personeli administrativ i UShAF.

Neni 13

1. Asnjë student nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një zgjedhjeje, apo komisioni, në UShAF.
2. Asnjë student nuk ka të drejtë që emri i tij të jetë në më shumë se një listë të kandidatëve.
3. Të gjithë anëtarët e Komisionit Qendror Zgjedhor dhe të Komisionit Zgjedhor duhet të nënshkruajnë një deklaratë me shkrim, e cila përgatitet nga Kryesuesi i

S. D.

Komisionit Qendror Zgjedhor, e cila thotë se ata/ato do të punojnë gjatë mandatit të tyre me përpikëri në mënyrë të paanshme dhe me ndërgjegje të plotë.

4. Këshilli Drejtues ka të drejtë që përkohësisht të suspendojë anëtarët e Komisionit Zgjedhor me rekomandim të kryesuesit të Komisionit Qendror Zgjedhor, në rast të ndonjë shkelje të dëshmuar të rregullave të kësaj Rregulloreje nga anëtarët përkatës. Në këtë rast, pozita nuk do të riplotësohet për periudhën gjatë suspendimit.

Neni 14

1. Kryetari i Komisionit Qendror Zgjedhor është përgjegjës për:
 - Thirrjen e takimeve të Komisionit Qendror Zgjedhor;
 - Udhëheqjen e takimeve;
 - Udhëzimin për procesin e vendimmarrjes;
 - Përgatitjen e procesverbalit të takimeve;
 - Ekzekutimin e vendimeve të Komisionit Qendror Zgjedhor;
 - Koordinimin e punës me Komisionin Zgjedhor.
2. Këshilli Drejtues është i obliguar që të ofrojë mbështetje të mjaftueshme administrative për kryesuesin e Komisionit Qendror Zgjedhor, në mënyrë që t'i përmbushë obligimet e përshkruara nga kjo Rregullore, sipas dinamikës së miratuar për zgjedhjet në UShAF.
3. Në rast se kryetari mungon, përgjegjësitë sipas paragrafit (1) të këtij neni, do t'i marrë zëvendëskryetari.

Neni 15

1. Në rast të dorëheqjes së hershme të anëtarëve, ashtu si janë listuar në nenin 11 dhe 12 të kësaj Rregulloreje, Këshilli Drejtues duhet të bëjë nominimin e anëtarit brenda periudhës sa më të shkurtër.
2. Në rast të mungesës së kuorumit të Komisionit Qendror Zgjedhor, për shkak të mospërcaktimit të nominimit, kryetari i KQZ-së ka të drejtën të marrë vet vendime.

Neni 16

1. Në Komisionin Qendror Zgjedhor, duhet të jenë prezentë kryetari dhe së paku edhe dy anëtarë, që të ketë kuorum.

2. Në rast se mungon kuorumi, kryetari mund të thërrasë një takim tjetër brenda 48 orësh.
3. Në rast se mungon kuorumi gjatë dy takimeve të njëpasnjëshme, kryetari e gëzon të drejtën e marrjes së vendimeve për temat e rendit të ditës.
4. Vendimet e Komisionit Qendror Zgjedhor dhe Komisionit Zgjedhor merren me shumicë votash.
5. Në rast të votimit të barabartë, vota e kryetarit është vendimtare.

Neni 17

1. Kryetari obligohet që ta ftojë mbledhjen e Komisionit Qendror Zgjedhor në afatin e paraparë sipas kësaj Rregulloreje, më së voni 24 orë pasi të njoftohen për rastin përkatës.
2. Thirrja (ftesa) duhet t'i dorëzohet anëtarëve, më së voni një ditë para takimit. Ftesa duhet të përmbajë rendin e ditës.
3. Secili anëtar i Komisionit Qendror Zgjedhor ka të drejtë t'ia parashtrijë kërkesën kryetarit për të bërë thirrjen e takimit, duke dërguar me shkrim një argument dhe një rend të ditës. Takime të tilla duhet të thirren brenda 24 orëve pas pranimit të kërkesës.

Neni 18

1. Procesverbali i takimit duhet të përgatitet për çdo takim të Komisionit Qendror Zgjedhor dhe të Komisionit Zgjedhor.
2. Procesverbali duhet të përfshijë një përshkrim të shkurtër të takimit dhe të vendimeve që janë marrë. Procesverbali duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët prezentë të Komisionit. Në rast se refuzohet nënshkrimi, emri i anëtarit dhe arsyt, duhet të jepen dhe t'i bashkëngjiten procesverbalit.
3. Të gjitha procesverbalet e takimeve nga Komisioni Qendror Zgjedhor dhe të Komisionit Zgjedhor duhet të ruhen nga kryetari. Një kopje për secilin takim duhet t'i jepet Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit dhe duhet të ruhet në arkivë për një periudhë 3 vjeçare.

Neni 19

1. Takimi i Komisionit Zgjedhor duhet të thirret nga kryetari.

S.O.

2. Për udhëheqjen e takimeve, sipas paragrafit 1 të këtij neni, vlejné rregullat përkatëse të kësaj Rregulloreje për KQZ.

Neni 20

1. Komisioni Qendror Zgjedhor ka këto përgjegjësi:
 - Përcaktimin dhe zbatimin e dinamikës së zgjedhjeve;
 - Përgatitjen e listave për zgjedhje të personave me të drejtë zgjedhjeje;
 - Vendimet rreth kundërshtimeve kundër listës së zgjedhjeve;
 - Konstatimin e numrit të përgjithshëm të mandateve;
 - Vlerësimin e listës së kandidatëve;
 - Kryesimin e procedurave zgjedhore;
 - Verifikimin e identitetit të votuesve;
 - Konstatimin e rezultateve të zgjedhjeve;
 - Dhënien e mandatit për t'i pranuar organizatat me të drejtë zgjedhjeje;
 - Informimin e kandidatëve;
 - Shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve;
 - Ndërrimin e mandatit;
 - Konstituimin e Parlamentit të Studentëve;
2. Koordinimin e punëve të Komisionit Zgjedhor;
3. Lista e organizatave të pranura të studentëve dhe listat e kandidatëve duhet të shpallen publikisht, më së voni 7 ditë para ditës së zgjedhjeve.
4. Rezultatet e zgjedhjeve duhet të shpallen publikisht brenda 5 ditëve pas ditës së zgjedhjeve. Mandatet duhet të caktohen në kohë të njëjtë.

Neni 21

1. Administrata Qendrore është e obliguar që për KQZ të sigurojë listat përfundimtare me të gjitha të dhënat e studentëve që kanë të drejtë vote, më së voni 7 ditë pas shpalljes së zgjedhjeve.
2. Studentët me të drejtë vote duhet t'i përmbushin këto dy kualifikime si në vijim:
 - Të kenë statusin e studentit të rregullt, sipas nenit 132 të Statutit të Universitetit;

- Të kenë ID kartën që dëshmon se studenti është i regjistruar dhe i cili është i vlefshëm për datën kualifikuese të zgjedhjeve, ashtu si definohet nga Këshilli Drejtues.
3. Data kualifikuese për listën e studentëve që kanë të drejtë të votojnë do të caktohet 15 ditë para zgjedhjeve.
 4. Lista e studentëve që kanë të drejtë të votojnë duhet të bëhet publike dhe të jetë e qasshme për KQZ-në brenda afatit 13 ditor, para datës së mbajtjes së zgjedhjeve.
 5. Brenda kësaj periudhe, secili student ka të drejtë të ankohet kundër përmbajtjes së listës përmes deklaratës me shkrim, e cila mund t'i paraqitet KQZ-së.
 6. Kundërshtimet kundër listës së studentëve me të drejtë vote duhet të paraqiten më së voni 10 ditë para zgjedhjeve dhe duhet të vendoset për ato kundërshtime brenda 24 orëve, pas pranimit të tyre.

VI. Lista e kandidatëve

Neni 22

1. Organizatat e studentëve me të drejtë pjesëmarrje në zgjedhje për Parlamentin Studentor, sipas parimeve të kësaj Rregulloreje, duhet të dorëzojnë listat e kandidatëve në KQZ përmes postës së regjistruar, më së voni një (1) ditë pas certifikimit të organizatave studentore. Pasi të dorëzohet lista në KQZ, ajo nuk do të ndryshohet më.
2. Secila listë e kandidatëve duhet të përmbajë:
 - Emrin e organizatës të studentëve që bënë fushatë;
 - Organin qeverisës që do të zgjidhet, (parlamentin) e studentëve;
 - Listën prioritare të kandidatëve;
 - Deklaratën e pëlqimit të kandidatëve;
 - Përcaktimin e të adresuarit të autorizuar të organizatës studentore.
3. Në rast të emrave kontradiktorë të dy apo më shumë organizatave të ndryshme studentore, KQZ duhet të kërkojë nga të adresuarit e autorizuar të secilës organizatë të përfshirë që të gjejnë një zgjidhje, një ditë pas regjistrimit të organizatës studentore. Në rast se nuk gjendet ndonjë marrëveshje deri në atë datë, KQZ vendosë dallimin e termeve për secilën organizatë të përfshirë.
4. Përdorimi i emrave të partive politike ekzistuese të Kosovës, si emra të organizatave të studentëve, nuk do të lejohen.

Neni 23

1. Lista e kandidatëve e organizatave studentore duhet të përbëhet prej maksimumit, sa dyfishi i kandidatëve të numrit të përgjithshëm të mandateve të lejueshme, që të zgjidhet një organ (trup). Kandidatët tepricë duhet të hiqen prej listës nga Komisioni Zgjedhor.
2. Për secilin kandidat që duhet të përmbushë kualifikimin sipas nenit 21, informacionet (të dhënat) si në vijim duhet të ofrohen, në mënyrë që kandidatura të jetë e ligjshme:
 - Emri dhe Mbiemri;
 - Vendi i lindjes;
 - Data e lindjes;
 - Adresa;
 - Titulli i studimeve - fakulteti dhe programi i studimit;
 - Numri i ID kartelës;
 - Dëshmia e regjistrimit të studentit të rregullt;
 - Deklarata e miratimit (pëlqimit);
3. Kandidatët, të cilët nuk i përmbushin këto kualifikime për të pasur të drejtë vote sipas nenit 21, KQZ duhet t'i heqë nga lista e kandidatëve.

Neni 24

1. Në listën e kandidatëve, çdo i treti kandidat duhet të jetë nga gjinia femërore.
2. Për detaje të tjera të rregullave dhe nevojave gjinore të listës së kandidatëve vlen Ligji për Barazi Gjinore nr. 05 /L-020.

Neni 25

1. Vlefshmëria e listës së kandidatëve duhet të kontrollohet nga KQZ, menjëherë pasi të merret nga organizata studentore.

S.0.

2. Në rast të parregullsive të cilat kërkojnë përmirësim, lista e kandidatëve duhet të kthehet prapa te i adresuari i autorizuar i organizatës studentore përkatëse, me shpjegimet e nevojshme për përmirësim.
3. Lista e përmirësuar e kandidatëve duhet të dorëzohet te KQZ nga organizata studentore, më së voni 5 ditë para zgjedhjeve.
4. Nëse lista zgjedhore, apo lista e kandidatëve, e cila është kthyer për përmirësim, nuk dorëzohet brenda periudhës kohore të caktuar, kandidatura e organizatës përkatëse studentore njihet si e tërhequr.

Neni 26

1. Secila organizatë studentore do të ketë të drejtën të tërheqë kandidaturën e saj përmes deklaratës me shkrim, e cila duhet të jetë e nënshkruar nga i adresuari i autorizuar dhe udhëheqësi i organizatës studentore, me së voni 15 ditë para zgjedhjeve.
2. Kandidatura e organizatës studentore do të njihet si e tërhequr, nëse numri i kërkuar i kandidatëve sipas kësaj Rregulloreje nuk është dhënë, për arsye se kandidatët kanë tërhequr kandidaturën me shkrim dhe deklaratë të nënshkruar, më së voni 15 ditë para zgjedhjeve.

Neni 27

1. Lista zgjedhore, apo lista e kandidatëve, e cila dorëzohet jashtë periudhës së caktuar, nuk do të pranohet nga KQZ.
2. Për vlerësimin e datës së saktë të dorëzimit, data e pullës postare, apo data e dorëzimit personal, do të jetë vendimtare.
3. Kryesuesi i KQZ-së është i obliguar dhe duhet të aranzhojë në periudhën para zgjedhjeve një fushatë informuese për studentët me të drejtë vote, duke i informuar për procedurat zgjedhore. Rektorati është i obliguar të ofrojë resurse të nevojshme për një proces të tillë zgjedhor dhe të njëjtat t'i bëjë publike.

VII. Mbajtja e zgjedhjeve

Neni 28

1. Qendrat e vendvotimit do të hapet në ora 7.00 dhe mbyllen në ora 19.00. Përjashtimisht nga kjo, nëse në kohën e mbylljes së vendvotimeve ka radhë të

S.O.

votuesve, atëherë koha e mbylljes së vendvotimit shtyhet deri në votimin e studentit të fundit.

2. Totali prej 12 orëve duhet të jetë në dispozicion për votim.
3. Numrin e vendvotimeve e cakton KQZ.

Neni 29

1. Komisioni Zgjedhor është i obliguar që të ofrojë vendvotim të përshtatshëm zgjedhor për mbajtjen e zgjedhjeve në UShAF. Pajisjet e nevojshme, siç janë kutitë e votimit, kabinat e votimit dhe pajisje tjera të nevojshme për votim, duhet të sigurohen nga KQZ.
2. Gjatë procesit të zgjedhjeve, në vendvotime mund të kenë qasje, përveç anëtarëve të Komisionit Zgjedhor, personat si në vijim:
 - Personeli mbështetës i Komisionit Zgjedhor;
 - Vëzhguesit zyrtarë të caktuar për zgjedhje;
 - Votuesit;
 - Personeli tjetër i caktuar zyrtar, përgjegjës për funksionim të rregullt të mbajtjes së zgjedhjeve.
3. Pasi vota të jetë hedhur, votuesit duhet të largohen nga vendvotimi pa vonesë.
4. Nëse paraqitet si e nevojshme për arsye të funksionimit të rregullt të procedurës zgjedhore, kryesuesi i komisionit zgjedhor do të ketë të drejtën të kufizojë qasjen e votuesve në vetëm nga një votues sipas radhës.

Neni 30

1. Secili vendvotim duhet të ketë së paku një kabinë votimi. Numri i përgjithshëm i kabinave të votimit që është i nevojshëm duhet të kalkulohet në atë mënyrë që, 80% e studentëve me të drejtë vote të kenë mundësi t'i hedhin votat, pa e vështirësuar periudhën votuese.
2. Kabina e votimit duhet të vendoset në atë pozicion, në mënyrë që votuesi të mos jetë i vëzhguar nga persona të tjerë, që janë të pranishëm në vendvotim gjatë procedurës së votimit.
3. Në rast se nuk ofrohen kabina të vendosura dhe të ndërtuara për votim, duhet të adaptohet një pjesë e mjaftueshme e dhomës në mënyrën e përshtatshme. Këto rregullime të përkohshme duhet të pranohen nga Komisioni Zgjedhor, bazuar në inspektim individual.

4. Kabina e votimit duhet të përmbajë tavolinën me ulëse të lartë, apo me banak të lartë. Duhet të ketë dritë të mjaftueshme dhe duhet të ofrohet material për shkrim për të bërë votimin në fletëvotim.

Neni 31

1. Të gjitha fletëvotimet duhet të jenë me numër të dyfishtë serik, të jenë të vulosura në vend të njëjtë, të palosen, së paku një herë, para se të hedhen në kutinë e votimit.

Neni 32

1. Komisioni Zgjedhor është përgjegjës për mbajtjen e procedurave zgjedhore, në pajtueshmëri me Rregulloren për zgjedhje studentore.

Neni 33

1. Votimi duhet të bëhet në formë personale. Të verbërit, personat me aftësi të kufizuara, nga të cilët nuk pritët që të mund të votojnë në mënyrë vetanake, duhet të kenë të drejtën të zgjedhin një person përcjellës, i cili do t'i mbështesë ata/ato gjatë procedurës së zgjedhjes.
2. Përveç përjashtimit nga paragrafi (1) i këtij neni, në kabinën e votimit mund të hyjë vetëm nga një person, sipas radhës.

Neni 34

1. Secili votues është i obliguar ta dëshmojë identitetin e tij/saj para Komisionit Zgjedhor përmes paraqitjes së ID kartës, apo në rast të mungesës së ID ndonjë dokument valid të identifikimit, sipas vendimit të Këshillit Drejtues.
2. Vlerësimi i pranueshmërisë duhet të bëhet ekskluzivisht në bazë të listës zgjedhore për personat që kanë të drejtë votimi.

Neni 35

1. Secili student me të drejtë vote duhet të dëshmojë identitetin, ashtu si u përshkrua më lartë.
2. Kryesuesi i Komisionit Zgjedhor ia jep në dorë fletën votuese të duhur studentit.

S. O.

3. Secili student me të drejtë vote, ka të drejtë të votojë për:
4. Parlamentin Studentor të UShAF.
5. Kryesuesi i Komisionit Zgjedhor e drejton votuesin për të hyrë në kabinën e votimit.
6. Votuesi e mbush fletëvotimin, e palos një herë dhe del jashtë kabinës së votimit.
7. Kryesuesi i Komisionit Zgjedhor e tërheqë mbulesën e kutisë së votimit dhe votuesi e futë fletëvotimin e palosur në kuti të votimit.
8. Në rast se ndodh ndonjë gabim nga votuesi gjatë mbushjes në fletëvotim, Komisioni Zgjedhor është i obliguar të ofrojë edhe një fletëvotim për votuesin me kërkesën e votuesit. Fletëvotimi paraprak duhet të griset nga votuesi para dorëzimit, në prani të Komisionit Zgjedhor.
9. Dorëzimi i fletëvotimit shtesë duhet të regjistrohet në protokollet e votimit.

Neni 36

1. Emri i votuesit, i cili ka hedhur votën, duhet të regjistrohet në regjistrin e votimit nga një anëtar i Komisionit Zgjedhor.
2. Emri duhet të regjistrohet me numrin sipas rreshtit dhe me numrin original të listës së votuesve me të drejtë vote.
3. Anëtar i tjetër i Komisionit Zgjedhor duhet të evidentojë emrin e votuesit në listën e votuesve me të drejtë vote.

Neni 37

1. Votimi duhet të regjistrohet në pjesën e prapme të ID-së së studentit me një shënim të caktuar.
2. Për procedurat tjera gjatë votimit vlejné parimet e përgjithshme të procedurave zgjedhore.

Neni 38

1. Në rast të dyshimit, sa i përket identitetit të studentit, Komisioni Zgjedhor ka të drejtë të kërkojë dokumente shtesë të identifikimit.
2. Nëse identiteti nuk mund të qartësohet, studenti nuk lejohet të votojë.
3. Pasi të dorëzohet fletëvotimi, asnjë dyshim tjetër sa i përket identitetit të votuesit nuk është i lejueshëm ligjërisht.

Neni 39

1. Renditja e organizatave studentore në fletëvotim duhet të përcaktohet përmes hedhjes së shortit (lotarisë), e cila mbahet nga Komisioni Qendror Zgjedhor.
2. Shtypja e fletëvotimeve duhet të aranzhohet nga kryesuesi i Komisionit Qendror Zgjedhor në kohën e duhur dhe pasi të shpallen listat zgjedhore.

Neni 40

Fletëvotimi njihet si i vlefshëm, nëse aty ka evidencë të padiskutueshme për organizatën studentore që votuesi e ka zgjedhur. Ky është rasti kur votuesi markon qarkun në të majtë të emrit të organizatës së pranueshme me një iks (x), apo shenja tjera të kësaj natyre, në mënyrë që qëllimi i votuesit për të zgjedhur këtë organizatë tregohet me qartësi.

Neni 41

1. Fletëvotimi njihet si i pavlefshëm, nëse:
 - Përdoret edhe një fletëvotim përveç fletëvotimit të rregullt;
 - Atëherë kur fletëvotimit i shqyhet një pjesë, në atë mënyrë që nuk do të ketë mundësi të qartësohet se cila organizatë studentore është votuar;
 - Atëherë kur asnjë organizatë studentore nuk është markuar;
 - Atëherë kur dy apo më shumë organizata studentore janë markuar;
 - Atëherë kur markimet, apo shenjat në fletëvotime, janë bërë në atë mënyrë që nuk mund të vërehet asnjë përcaktim të një organizate studentore, nga i cili nuk mund të nxirret asnjë përfundim.
2. Fjalët, komentet, apo shenjat e tjera, të cilat shënohen në fletëvotim, e bëjnë fletëvotimin të pavlefshëm.

Neni 42

1. Pasiqë periudha zgjedhore prej 12 orëve të përfundojë, kryesuesi i Komisionit Zgjedhor, deklaron përfundimin e votimeve. Vendvotimi duhet të mbyllet vetëm nga anëtarët e Komisionit Zgjedhor, personelit mbështetës dhe vëzhguesve, të cilët mbesin në vendvotim.
2. Komisioni Zgjedhor duhet t'i përziejë fletëvotimet në kutinë e votimit, pastaj i zbrazë dhe i numëron:

- Numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve për Parlament Studentor të UShAF,
 - Numrin e përgjithshëm të votuesve të regjistruar në regjistrat e votimeve,
 - Në rast të mospërputhjes së rezultateve sipas pikës 1 dhe 2 të këtij paragrafi, identifikohen arsyet e kësaj mospërputhjeje.
3. Komisioni Zgjedhor shpalos fletëvotimet.
 4. I rregullon ato sipas organizatave garuese, kontrollon vlefshmërinë, identifikon fletëvotimet e pavlefshme sipas numrit të radhës dhe e përcakton:
 - Numrin e përgjithshëm të votave të hedhura;
 - Numrin e përgjithshëm të votave të hedhura të pavlefshme;
 - Numrin e përgjithshëm të votave të hedhura të vlefshme;
 - Numrin e përgjithshëm të votave të vlefshme për secilën organizatë studentore.
 5. Rezultatet sipas pikës (3) të këtij neni, menjëherë pas numërimit të votave, i dorëzohen kryesuesit të KQZ në kopje të fortë fizike.

Neni 43

1. Komisioni Zgjedhor brenda 24 orëve pas mbylljes së vendvotimit, duhet të dorëzojë në KQZ një raport të detajuar me shkrim për procedurën zgjedhore dhe rezultatet e zgjedhjeve.
2. Raporti duhet të përmbajë si në vijim:
 - Emrin e vendvotimit dhe datën(at) e votimit;
 - Emrat e anëtarëve të komisionit;
 - Emrat e vëzhguesve dhe monitoruesve;
 - Numrin e saktë të fletëvotimeve të dorëzuara për secilën organizatë studentore që është në zgjedhje;
 - Kohën e fillimit dhe të mbarimit të periudhës së zgjedhjeve;
 - Vendimet potenciale të Komisionit Zgjedhor sa i përket lejimit, apo moslejimit të votuesve për votim;
 - Vendime tjera të Komisionit Zgjedhor gjatë periudhës së zgjedhjeve (p.sh. pengimet gjatë periudhës së zgjedhjeve, votimet përmes përcjelljes mbështetëse të ndonjë personi, etj.).
3. Të bashkangjiturat si në vijim duhet t'i shtohen këtij raporti:

- Lista e votuesve me të drejtë vote;
 - Regjistri i votimit;
 - Votat e pavlefshme, të ndara, të paketuara dhe të markuara për zgjedhjet studentore;
 - Votat e vlefshme, të ndara, të paketuara dhe të markuara për secilën organizatë studentore që është në zgjedhje;
 - Fletëvotimet e pashfrytëzuara, të ndara, të paketuara dhe të markuara.
4. Raporti duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm të Komisionit Zgjedhor dhe vëzhguesve. Në rast të refuzimit të nënshkrimit, arsyet duhet të evidentohen në librin e protokollit të zgjedhjeve.

Neni 44

1. Në rast të rrethanave të veçanta, apo incidenteve në vendvotim, Komisioni Zgjedhor ka të drejtë të ndërpresë procesin zgjedhor dhe të vazhdojë votimin në një ditë tjetër.
2. Secila shtyrje e zgjedhjeve duhet të shpallet në publik, pa vonesë, nga Kryesuesi i Komisionit Zgjedhor.
3. Nëse periudha votuese vetëm ka filluar dhe pastaj pengohet, të gjitha veprimet zgjedhore, fletëvotimet dhe kutitë e votimit duhet të mbyllen nga kryesuesi i Komisionit Zgjedhor, derisa procedura zgjedhore të vazhdohet.

Neni 45

1. Shpërndarja e mandateve duhet të kalkulohet nga Komisioni Qendror Zgjedhor në pajtueshmëri me rregullat e kësaj Rregulloreje.

Neni 46

1. Rezultati preliminar i zgjedhjeve duhet të publikohet nga KQZ, më së largu 24 orë pas përfundimit të zgjedhjeve.
2. Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve duhet të publikohet nga KQZ, më së largu 5 ditë pas përfundimit të zgjedhjeve.
3. Shpallja duhet të përmbajë:
 - Rezultatin e zgjedhjeve në shifra, të renditur sipas organizatës studentore.

S.O.

- Numrin e përgjithshëm të mandateve për secilën organizatë studentore të votuar.

Neni 47

1. Mandatarët e zgjedhur duhet të informohen nga Komisioni Qendror Zgjedhor në ditën e shpalljes së rezultateve përfundimtare.
2. Mandati duhet të njihet si i pranuar, nëse mandatarin nuk e kundërshton zgjedhjen e tij brenda dy ditëve, pasi që rezultati përfundimtarë i zgjedhjeve të jetë shpallë.
3. Në rast të kundërshtimit të mandatit nga mandatarin, mandati duhet t'i caktohet kandidatit përcjellës sipas listës së kandidatëve.

Neni 48

1. Kundërshtimet kundër procedurave dhe rezultateve të zgjedhjeve studentore duhet të dorëzohen te KQZ brenda 48 orëve, pasi të jenë shpallë rezultatet preliminare të zgjedhjeve.
2. Kundërshtimet për arsye të shkeljeve të rregullave të kësaj Rregulloreje duhet të shqyrtohen dhe të vendosen nga Këshilli Drejtues, si shkallë e dytë.
3. Çdo ndryshim në rezultatin e zgjedhjeve për arsye të pranimit të ankesave duhet të shpallet publikisht nga KQZ.
4. Vendimi i Këshillit Drejtues është përfundimtar.
5. Në rast se zgjedhjet deklarohen të pavlefshme, zgjedhjet e tjera duhet të mbahen dhe caktimi i mandateve duhet të suspendohet.
6. Çdo ndryshim në rezultatin e zgjedhjeve për arsye të pranimit të ankesave, duhet të shpallet publikisht nga kryesuesi i KQZ.

Neni 49

1. Nëse Këshilli Drejtues konstaton se shkeljet e procedurave zgjedhore kanë qenë të atyre përmasave që esencialisht kanë ndikuar në rezultatin zgjedhor, atëherë procesi zgjedhor do të përsëritet brenda 15 ditëve, pas ditës së marrjes së vendimit të Këshillit Drejtues.


Neni 50

1. Rregullorja hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i UShAF.

S. O.

2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për zgjedhjet e studentëve në UShAF nr. 755/20, e dt. 02.03.2020.

Prof. As. Dr. Samet Dalipi



Kryesues i Këshillit Drejtues

